



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 28.09.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:**  
**“LINJA E TENSIONIT TË LARTË 220 KV**  
**NËNSTACIONI KARAVASTA – NËNSTACIONI FIER”, ME VENDNDODHJE NË**  
**BASHKINË FIER**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Karavasta Solar“ sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Linja e Tensionit të Lartë 220 kV Nënstacioni Karavasta – Nënstacioni Fier”, me vendndodhje në Bashkinë
- 2.
3. Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Karavasta Solar“ sh.p.k.
4. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.
6. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



  
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

